



Elton Bodini

Drejtor Drejtorie

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT


Z. Elton Bodini, ka përfunduar studimet e larta në Master Shkencor në Inxhinieri Mjedisi dhe Master për Administrim Biznesi. Formimi i tij akademik, që ndërthur njohuritë teknike me aftësitë menaxheriale, ka kontribuar në ndërtimin e një profili të konsoliduar profesional në fushat e menaxhimit të shërbimeve administrative, logjistikës dhe administrimit institucional.


Z. Bodini që prej muajit tetor 2025, ushtron detyrën e Drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse në Kontrollin e Lartë të Shtetit, ku është përgjegjës për organizimin, mbikëqyrjen dhe koordinimin e shërbimeve administrative dhe logjistike të institucionit. Ai ka një përvojë të gjerë në administratën publike, duke punuar në fusha që lidhen me menaxhimin e shërbimeve administrative, logjistikës, transportit, infrastrukturës dhe aseteve institucionale.


Gjatë karrierës së tij profesionale, ka marrë pjesë në një sërë trajnimesh dhe konferencash brenda dhe jashtë vendit, me fokus në menaxhimin e shërbimeve administrative, dhe forcimin e kapaciteteve institucionale.



Kontakt

 ebodini@klsh.org.al

 Rruga "Abdi Toptani", Tiranë
Shqipëri

 www.klsh.org.al